



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

RELACION
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR NJOHJEN E KUALIFIKIMEVE PROFESIONALE TË FITUARA NË SHTETET ANËTARE TË BASHKIMIT EVROPIAN, ZONËS EKONOMIKE EVROPIANE DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, SI DHE PËR VLERËSIMIN E PROPORCIONALITETIT TË RREGULLAVE PËR AKSESIN DHE USHTRIMIN E PROFESIONEVE TË RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për njohjen e kualifikimeve profesionale të fituara në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, Zonës Ekonomike Evropiane dhe Konfederatës së Zvicrës, si dhe për vlerësimin e proporcionalitetit të rregullave për aksesin dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë” i propozuar nga Ministri i Arsimit (MA), synon harmonizimin e kuadrit ligjor vendas me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, mbi njohjen e kualifikimeve profesionale, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 255, datë 30.9.2005, e ndryshuar me: Direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354/132, datë 28.12.2013; Direktivën (BE) 2024/505 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shkurt 2024, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2024/505, datë 12.2.2024 (referuar në vijim si “Direktiva 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale” ose thjesht “Direktiva 2005/36/KE”).

Gjithashtu, projektligji përafron plotësisht Direktivën (BE) 2018/958 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 28 qershor 2018, mbi testin e proporcionalitetit përpara miratimit të rregullave të reja për profesionet, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 173, datë 09.07.2018, (referuar në vijim si “Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit” ose thjesht “Direktiva (BE) 2018/958”).

Për të garantuar të drejtën e vendosjes dhe lirinë për ofrimin e shërbimeve, të cilat janë thelbësore për funksionimin e tregut të përbashkët sipas Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian

(TFBE), *acquis communautaire* harmonizon rregullat për profesionet e rregulluara, duke mundësuar njohjen reciproke të kualifikimeve profesionale mes vendeve anëtare.

Direktiva 2005/36/KE vendosi një regjim të unifikuar për njohjen e kualifikimeve profesionale brenda BE-së, duke e bërë të mundur që individët e kualifikuar në një profesion të rregulluar në një shtet anëtar (shteti anëtar i origjinës) të kenë të drejtën të ushtrojnë të njëjtin profesion në një shtet tjetër anëtar (shteti anëtar pritës). Ajo bashkoi dhe standardizoi rregullat e shpërndara më parë në disa direktiva të BE-së.

Për më tepër, Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit synon të harmonizojë rregullat për vlerësimin e proporcionalitetit përpara miratimit të rregullave të reja për profesionet e rregulluara. Në përputhje me *acquis*, çdo rregullim i ri që kufizon ushtrimin e një profesioni duhet të jetë proporcional dhe të mos krijojë pengesa të pajustificuara për të drejtën e vendosjes dhe lirinë e ofrimit të shërbimeve.

Shtetet anëtare kanë përgjegjësinë të vlerësojnë proporcionalitetin e masave të reja, duke kryer një analizë gjithëpërfshirëse për përshtatshmërinë e tyre. Për këtë qëllim, Direktiva (BE) 2018/958 vendos një kuadër të unifikuar analitik në nivel BE për aplikimin e testit të proporcionalitetit në procesin e hartimit të rregullave për ushtrimin e profesioneve.

Ky projektligj paraqitet në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis communautaire*, si pjesë e detyrimeve të përcaktuara në nenin 70 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA), i cili detyron Shqipërinë të sigurojë që legjislacioni i saj ekzistues dhe i ardhshëm të jetë gradualisht në përputhje me atë të BE-së. dhe të zbatohet në mënyrë efektive.

Anëtarësimi në BE dhe integrimi i plotë evropian janë objektiva strategjike të Shqipërisë, të cilët kërkojnë harmonizimin e kuadrit ligjor, ekonomik dhe institucional me standardet e BE-së. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030 përcakton përafrimin e plotë të kuadrit ligjor si një prioritet kyç për arritjen e anëtarësimit.

Gjatë procesit të *screening* mbi përafrimin me Kapitullin 3 të *acquis communautaire*, si dhe në bazë të raporteve të progresit të Komisionit Evropian, është identifikuar nevoja për të transpozuar plotësisht Direktivën 2005/36/KE mbi njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit.

Në nivel rajonal, Shqipëria ka nënshkruar marrëveshjet për njohjen e kualifikimeve profesionale në profesionet sektoriale, në kuadër të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), të cilat synojnë lehtësimin e mobilitetit të profesionistëve. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave ka miratuar një sërë aktesh për përafrimin e kërkesave minimale të formimit për shtatë profesione të rregulluara (mjek, infermier, stomatolog, kirurg veterinar, mami, farmacist dhe arkitekt) në përputhje me Direktivën 2005/36/KE.

Me gjithë hapat e ndërmarrë deri tani, sistemet e njohjes së kualifikimeve profesionale sipas Direktivës 2005/36/KE dhe rregullat për zbatimin e testit të proporcionalitetit sipas Direktivës

(BE) 2018/958 mbeten ende të pa transpozuar në legjislacionin shqiptar. Për këtë arsye, ndërhyrja legjislative synon përafrimin e plotë të kuadrit ligjor vendas me ndryshimet më të fundit të Direktivës 2005/36/KE, veçanërisht në raport me profesionet sektoriale, duke siguruar një sistem të njësuar dhe funksional për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Objektivat kryesore të kësaj politike që propozohet janë:

- Përafrimi i plotë i kuadrit ligjor vendas me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit, në përbushje të detyrimeve të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE);
- Zbatimi i masës përkatëse të parashikuar në PKIE 2024-2026, brenda tremujorit të tretë të vitit 2025.
- Harmonizimi me standardet e BE-së, duke krijuar një sistem të unifikuar për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe një kuadër të qartë analitik për zbatimin e testit të proporcionalitetit gjatë hartimit të rregullave të reja për profesionet, në përputhje me *acquis communautaire*;
- Përbushja e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve rajonale për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale në profesionet sektoriale;
- Lehtësimi i lëvizjes së lirë të profesionistëve brenda territorit të BE-së, duke siguruar njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale që nga momenti i anëtarësimit të Shqipërisë;

I. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është i parashikuar në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) 2024-2026 dhe pritet të shqyrtohet brenda tremujorit të tretë të vitit 2025.

II. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit është një domosdoshmëri në kuadër të angazhimeve të Shqipërisë për integrimin në Bashkimin Evropian (BE).

Aktualisht, legjislacioni shqiptar nuk siguron një regjim të përafër me atë të BE-së dhe të plotë për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe vlerësimin e proporcionalitetit të rregullave të reja mbi profesionet e rregulluara. Kjo krijon pengesë për mobilitetin e profesionistëve, burokraci për

njohjen e diplomave dhe certifikatave, si dhe mungesë sigurie juridike për bizneset dhe institucionet arsimore.

Ky propozim ligjor synon të:

- Unifikojë dhe përmirësojë sistemin e njohjes së kualifikimeve profesionale, duke e përafruar atë me standardet e BE-së;
- Minimizojë barrierat administrative dhe burokratike për profesionistët e kualifikuar që kërkojnë të ushtrojnë profesionin e tyre në Shqipëri ose në vendet e BE-së;
- Sigurojë një metodologji të qartë për vlerësimin e proporcionalitetit të rregullave të reja mbi profesionet e rregulluara, duke shmangur kufizimet e pajustificuara dhe duke rritur transparencën;
- Përmirësojë lëvizshmërinë profesionale dhe tërheqjen e ekspertëve shqiptarë nga diaspora, duke reduktuar pengesat për kthimin e tyre në tregun shqiptar të punës;
- Mbështesë bizneset dhe punëdhënësit në qasjen ndaj një force punëtore të kualifikuar dhe të njohur në nivel ndërkombëtar;
- Rrisë cilësinë e shërbimeve të ofruara për qytetarët duke garantuar që profesionistët që operojnë në tregun shqiptar përmbushin standardet më të larta profesionale.

Përafrimi i kuadrit ligjor shqiptar me Direktivën 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe Direktivën (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit do të ketë një ndikim të gjerë dhe pozitiv në një sërë grupesh të interesit, duke sjellë përfitime të ndjeshme për të gjithë aktorët e përfshirë.

Qeveria dhe autoritetet publike do të kenë mundësinë të përmirësojnë harmonizimin e kuadrit ligjor shqiptar me *acquis communautaire*, duke siguruar një sistem më efikas për njohjen e kualifikimeve profesionale. Kjo do të mundësojë uljen e barrës burokratike dhe një qasje më transparente dhe të unifikuar për profesionet e rregulluara.

Profesionistët do të përfitojnë nga një sistem i qartë dhe i standardizuar, i cili do t'ju japë akses më të lehtë në tregun evropian të punës. Njohja e ndërsjellë e kualifikimeve profesionale do të lehtësojë mobilitetin e tyre, duke krijuar më shumë mundësi punësimi dhe zhvillimi profesional si brenda Shqipërisë, ashtu edhe jashtë saj.

Bazuar në aktet tanimë në fuqi si pjesë e përafrimit të Direktivës, Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL-të) do të kenë detyrimin të përshtatin programet akademike sipas standardeve të Bashkimit Evropian (BE), duke siguruar që diplomat dhe kualifikimet e lëshuara të jenë në përputhje me kriteret për njohje automatike në nivel evropian. Kjo do të rrisë cilësinë e arsimit në Shqipëri, duke mundësuar një sistem më të harmonizuar dhe konkurrues në raport me vendet e BE-së. Përputhshmëria me *acquis communautaire* do të përmirësojë besueshmërinë e IAL-ve shqiptare, duke i bërë më të preferuara për studentët vendas dhe të huaj dhe duke rritur vlerën e diplomave shqiptare në tregun ndërkombëtar të punës.

Urdhrat profesionalë do të kenë një kuadër më të qartë dhe të unifikuar ligjor, i cili do të garantojë standarde më të larta për ushtrimin e profesioneve të rregulluara. Kjo do të ndihmojë në forcimin e rolit të tyre si rregullatorë të profesioneve dhe në përmirësimin e bashkëpunimit me homologët e tyre në vendet e BE-së, duke siguruar shkëmbimin e praktikave më të mira dhe njohurive.

Studentët dhe profesionistët e ardhshëm do të përfitojnë nga një rritje e ndjeshme e mundësive për ushtrimin e profesionit të tyre brenda dhe jashtë vendit. Përshtatja e sistemit arsimor dhe njohja e ndërsjellë e kualifikimeve do t'i ndihmojë ata të kenë më shumë fleksibilitet dhe mobilitet profesional, duke reduktuar nevojën për të emigruar për të siguruar njohjen e diplomave dhe certifikatave të tyre.

Punëdhënësit dhe bizneset vendase do të kenë akses më të lehtë në profesionistë të kualifikuar, duke ulur kostot dhe kohën e procedurave të rekrutimit. Ky ndryshim do të kontribuojë në rritjen e konkurrencës, inovacionit dhe zhvillimin e një tregu më të hapur të punës, duke u mundësuar kompanive shqiptare të kenë një fuqi punëtore të përgatitur sipas standardeve të BE-së.

Qytetarët, si përfitues të drejtpërdrejtë të shërbimeve profesionale, do të kenë mundësinë të zgjedhin mes një game më të gjerë profesionistësh të kualifikuar, çka pritet të përmirësojë cilësinë e shërbimeve në sektorë të ndryshëm si shëndetësia, drejtësia, arkitektura dhe inxhinieria.

Ky ligj përfaqëson një hap të rëndësishëm për përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë ndaj BE-së, duke krijuar një sistem modern, efikas dhe të njësuar për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe testin e proporcionalitetit. Ai do të lehtësojë integrimin e profesionistëve shqiptarë në tregun evropian, do të rrisë besueshmërinë e institucioneve shqiptare të arsimit të lartë, dhe do të kontribuojë në zhvillimin e një tregu më të hapur dhe konkurrues për punë dhe shërbime profesionale. Këto reforma do të sjellin një përmirësim të ndjeshëm në cilësinë e shërbimeve, rritjen e lëvizshmërisë profesionale dhe fuqizimin e ekonomisë kombëtare, duke e afruar më tej Shqipërinë me tregun dhe standardet e BE-së.

MA ka një rol qendror dhe strategjik në harmonizimin e legjislationit, koordinimin ndërinstitutional dhe zbatimin e reformave për njohjen e kualifikimeve profesionale.

Zbatimi i ligjit horizontal nuk mund të realizohet pa një kornizë të plotë rregullatore, e cila sigurohet përmes hartimit dhe miratimit të akteve të tjera nënligjore.

MA, në koordinim me institucionet e tjera të përfshira do të jete përgjegjëse të sigurojë që ky proces të zbatohet në mënyrë të plotë dhe efektive, duke krijuar një sistem të besueshëm, të qëndrueshëm dhe të harmonizuar për njohjen e kualifikimeve profesionale në Shqipëri.

Institucionet që kanë përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të siguruar që realizimin e procesit në mënyrë të plotë dhe efektive, duke mbuluar të gjitha profesionet e rregulluara dhe sektorët përkatës, si janë identifikuar në procesin e *screening*, janë:

- Ministria e Arsimit
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
- Urdhri i Veterinerëve
- Urdhri i Mjekëve
- Urdhri i Infermierëve
- Urdhri i Farmacistëve
- Urdhri i Stomatologëve
- Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Në këtë kontekst, MA do të udhëheqë miratimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit horizontal, si dhe të akteve të tjera nënligjore që do të sigurojnë përafrimin e plotë me *acquis*.

- Ministrinë e linjës do të kenë rol kyç në zbatimin e masave specifike për profesionet që mbikëqyrin, duke garantuar integritetin e standardeve të BE-së në sistemin kombëtar.
- Urdhrat profesionalë dhe dhomat e specializuara do të ndihmojnë në zbatimin e rregullave të njohjes dhe përshtatjes së kualifikimeve profesionale, duke ofruar udhëzime dhe mekanizma rregullues për profesionistët e rregulluar.

III. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji, që propozohet për miratim është në përputhje me nenet 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës do të ketë vendin e tij në rendin juridik shqiptar, i cili përcaktohet nga neni 116/1 i Kushtetutës.

Baza ligjore për propozimin e këtij projektligji, sipas hierarkisë ligjore është përmbledhur si më poshtë:

- nenin 81 të Kushtetutës, i cili përcakton se: “...*të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës*”.
- nenin 26, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, i cili përcakton se: “*Projektaktet, që u përkasin institucioneve të tjera qendrore,*

në varësi të Kryeministrit ose të ministrit përkatës, paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, me propozimin e Kryeministrit ose të ministrave përkatës”.

- pikën 3, të rregullores së Këshillit të Ministrave, miratuar me vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, i ndryshuar, sipas së cilës: *“Të drejtën për të propozuar projektakte për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, e kanë Kryeministri dhe çdo ministër”.*

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht nenin 11 dhe nenin 49.

Gjithashtu ky projektligj është në përputhje me parashikimet në nenet 49-59, të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe detyrimet që rrjedhin prej tyre për përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë së ofrimit të shërbimeve me *acquis*-në e BE-së në këtë fushë.

Projektligji i propozuar krijon një kuadër të qëndrueshëm ligjor për të gjithë procesin e rishikimit të legjislacionit sektorial, me qëllim përafrimin e tij me *acquis*-në e BE-së për të drejtën e vendosjes dhe lëvizjen e lirë të shërbimeve.

Përafrimi i Direktivës 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale dhe i Direktivës (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit në një ligj të vetëm është vlerësuar nder te tjera edhe në raport me ligjin nr. 10171, datë 22.10.2009, “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ky ligj është i përafëruar pjesërisht me disa nga nocionet e Direktivës 2005/36/KE, duke përfshirë përkufizime bazë si “profesion i rregulluar”, “kualifikim profesional” dhe “praktikë profesionale”, por pa reflektuar të gjitha kërkesat e *acquis* mbi njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale dhe testin e proporcionalitetit.

Duke marrë parasysh se testi i proporcionalitetit është një mekanizëm horizontal, që lidhet drejtpërdrejt me lehtësimin e hyrjes në tregun e punës për profesionistët e rregulluar, përfshirja e tij në ligjin për njohjen e kualifikimeve profesionale është qasja më e arsyeshme. Kjo shmang rregullime të fragmentuara dhe të pakoordinuara, të cilat mund të lindin nëse proporcionaliteti përfshihet në ligjin ekzistues për profesionet e rregulluara.

Ndryshimi i ligjit për profesionet e rregulluara për të integruar proporcionalitetin do të kërkonte rishikimin tërësor të tij, duke krijuar komplikime shtesë dhe vonesa në procesin e përafrimit me BE-në. Për këtë arsye, është më efikase që proporcionaliteti të integrohet në një ligj të ri, i cili jo vetëm që përcakton rregullat për njohjen e kualifikimeve, por njëkohësisht siguron që çdo kufizim mbi ushtrimin e një profesioni të jetë i justifikuar dhe proporcional.

Kjo qasje siguron një aplikim të unifikuar të testit të proporcionalitetit për të gjitha profesionet e rregulluara, duke shmangur pasigurinë ligjore dhe interpretimet e ndryshme ndërmjet profesioneve të ndryshme. Gjithashtu, krijon një bazë të qartë për rishikimin e ardhshëm të ligjit për profesionet e rregulluara, duke lehtësuar procesin dhe shmangur nevojën për ndryshime të fragmentuara në periudha të ndryshme kohore. Në këtë mënyrë, çdo përditësim i ardhshëm i kuadrit ligjor mbi profesionet e rregulluara do të mbështetet në standarde të unifikuara për njohjen e kualifikimeve

dhe për testin e proporcionalitetit, duke garantuar një përafrim më efikas të Shqipërisë me acquis të BE-së dhe duke lehtësuar mobilitetin e profesionistëve në tregun e përbashkët evropian.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BASHKIMIT EVROPIAN (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektligj synon përafrim me parashikimet e Direktivës 2005/36/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shtator 2005, mbi njohjen e kualifikimeve profesionale, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 255, datë 30.9.2005, e ndryshuar me: Direktivën 2013/55/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 20 nëntor 2013, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 354/132, datë 28.12.2013; Direktivën (BE) 2024/505 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 7 shkurt 2024, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2024/505, datë 12.2.2024 (referuar në vijim si “Direktiva 2005/36/KE për njohjen e kualifikimeve profesionale” ose thjesht “Direktiva 2005/36/KE”).

Direktiva 2005/36/EC është përafruar pjesërisht nëpërmjet:

(i) Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM nr. 823, datë 28.12.2023. Ky vendim adreson, nga njëra anë, përcaktimin e elementeve që përbëjnë strukturën e programeve të studimit të formimit të vazhduar, të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me Rekomandimin e Këshillit të Evropës (2017/C 189/03), datë 22 maj 2017, “Mbi Kornizën Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës”, i cili ka shfuqizuar rekomandimin e mëparshëm të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të datës 23 prill 2008. Nga ana tjetër, vendimi përcakton elementet minimale të programeve të studimit për shtatë profesione të rregulluara – përkatësisht mjek, infermier, stomatolog, mjek veteriner, mami, farmacist dhe arkitekt – të cilat në këtë dokument referohen si “profesionet sektoriale”, në përputhje me kushtet minimale të formimit (“*minimum training conditions*”) të përcaktuara për këto profesione në Direktivën 2005/36/EC.

Ky vendim siguron një përafrim të pjesshëm me nenet 24, 31, 34, 38, 40, 41, 44 dhe 46 të Direktivës 2005/36/EC.

(ii) Përafrimi synohet të thellohet më tej nëpërmjet projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 824, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë””, i cili është aktualisht në proces përditësimi. Ky akt synon të harmonizojë kuadrin ligjor që vendos standardet shtetërore për sigurinë dhe cilësinë e programeve të studimit për specializimet afatgjata, në përputhje me parashikimet e Direktivës 2005/36/EC, si dhe me

(iii) projektligjin objekt të këtij relacioni.

Aktet e sipërpërmendura, së bashku, synojnë të sigurojnë transpozimin e plotë të Direktivës 2005/36/EC, duke përfshirë si aspektet e njohjes së përgjithshme dhe automatike të kualifikimeve profesionale, ashtu edhe mekanizmat për garantimin e cilësisë së formimit profesional.

Gjithashtu, projektligji përafron plotësisht Direktivën (BE) 2018/958 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 28 qershor 2018, mbi testin e proporcionalitetit përpara miratimit të rregullave të reja për profesionet, botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria L, nr. 173, datë 09.07.2018. (referuar në vijim si “Direktiva (BE) 2018/958 mbi testin e proporcionalitetit” ose thjesht “Direktiva (BE) 2018/958”).

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj synon rregullimin e njohjes së kualifikimeve profesionale në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Ai përcakton rregullat dhe procedurat për njohjen e kualifikimeve të fituara jashtë vendit, si dhe krijon mekanizma për vlerësimin e proporcionalitetit në rast të rregullimeve të reja profesionale.

Projektligji përbëhet nga 102 nene, të ndara në 8 tituj, të cilët trajtojnë aspekte të ndryshme të njohjes së kualifikimeve profesionale dhe të kërkesave të proporcionalitetit për njohjen e ndërsjellë të këtyre kualifikimeve.

TITULLI I –DISPOZITA TË PËRGJITHSHME - Nenet 1 – 6

Ky Titull përvijon kuadrin e projektligjit, mbi të cilin zhvillohen në titujt pasues, rregullat përkatëse për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të regjimit të Bashkimit Evropian për njohjen e ndërsjellë të kualifikimeve profesionale, duke përcaktuar objektin, qëllimin, fushën e zbatimit, përkufizimet kryesore, efektet e njohjes, si dhe mundësinë e aksesit të pjesshëm për ushtrimin e profesionit.

Objekti i projektligjit përfshin normimin e përgjegjësisë së autoriteteve kompetente shqiptare, në kuadër të rolit të tyre të dyfishtë si autoritet kompetent i shtetit pritës për profesionistët e kualifikuar jashtë, ashtu sikurse edhe për të lehtësuar lëvizjen e profesionistëve të kualifikuar në Shqipëri në një shtet anëtar tjetër, në lidhje me një sërë aspektesh në funksion të këtij regjimi të tregut të përbashkët evropian, si:

- i. Ushtrimi i përkohshëm i profesionit të rregulluar në një shtet anëtar të ndryshëm;
- ii. Njohja e kualifikimeve profesionale për qëllim të ushtrimit të përhershëm të profesionit të rregulluar në një shtet anëtar të ndryshëm;
- iii. Njohjen e praktikave profesionale të kryer në një shtet anëtar të ndryshëm;
- iv. Zbatimin e procedurave në sajë të Kartës Evropiane Profesionale;
- v. Vlerësimin e proporcionalitetit të ndërhyrjeve ligjore që lidhen me kushtet për aksesin dhe ushtrimin e profesioneve të rregulluara në Republikën e Shqipërisë.

Të gjitha këto aspekte synojnë të nxisin lëvizjen e lirë dhe ofrimin e shërbimeve nga profesionistët e kualifikuar në kuadër të një tregu të përbashkët evropian.

Fusha e zbatimit e projektligjit përcaktohet nga tre kritere:

- i) Kriteri i shtetësisë, për aq sa zbatohet për shtetasit e shteteve anëtare të BE-së, ZEE-së, Shqipërisë si dhe shtetasit e Konfederatës Zvicerane;
- ii) Kriteri i vendit ku janë fituar kualifikimet profesionale, për aq sa lidhet me një shtet anëtar të BE-së, ZEE-së dhe Konfederatës Zvicerane;
- iii) Kriteri i lidhjes me profesionet e rregulluara, që do të thotë se zbatohet për ato profesione që janë të rregulluara në Shqipëri. Në mënyrë të posaçme, përjashtohet profesioni i noterit dhe ato profesione për të cilat njohja e kualifikimeve bëhet nëpërmjet një akti ligjor të posaçëm të bazuar në një akt të BE-së.

Për të garantuar qartësi dhe njëtrajtshmëri në zbatim, ky titull ofron përkufizime të detajuara për terma thelbësorë si “kualifikime profesionale”, “dëshmi të kualifikimeve profesionale”, “profesion i rregulluar”, “autoriteti kompetent”, dhe “Kartë Profesionale Evropiane”.

Njohja e kualifikimeve profesionale i jep profesionistit të huaj të drejtën të ushtrojë profesionin në Shqipëri në të njëjtat kushte si shtetasit shqiptarë. Ligji gjithashtu parashikon mundësinë e aksesit të pjesshëm në një profesion të rregulluar. Kjo masë lejohet vetëm kur profesionisti është i kualifikuar në shtetin e tij të origjinës, por veprimtaria profesionale atje për të cilën është kualifikuar ndryshon thelbësisht nga ajo në Shqipëri, duke e bërë të pamundur zbatimin e masave kompensuese standarde pa ndjekur një program të plotë formimi. Aksesit i pjesshëm zbatohet vetëm nëse veprimtaria në fjalë mund të ndahet objektivisht nga pjesa tjetër e veprimtarive të profesionit.

TITULLI II – USHTRIMI I PËRKOHSHËM DHE I RASTËSISHËM I PROFESIONIT NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË - Nenet 7 – 14/1

Ky titull përmban parashikime që lidhen me ofrimin e shërbimeve në Shqipëri në mënyrë të përkohshme dhe të rastësishme, qoftë si punëmarrës, ose qoftë si të vetëpunësuar.

Si rregull, ofrimi i këtyre shërbimeve në mënyrë të përkohshme dhe të rastësishme nuk duhet të kufizohet nga kritere që lidhen me kualifikimet profesionale, për aq sa:

- i) profesionisti është i vendosur ligjërisht në shtetin e tij të origjinës;
- ii) zhvendoset fizikisht për të ofruar shërbimin;
- iii) dhe veprimtaria duhet të jetë e përkohshme dhe e rastësishme.

Për të filluar ofrimin e shërbimit, profesionisti duhet të paraqesë një deklaratë paraprake me shkrim. Kjo deklaratë, e vlefshme për një vit dhe e rinovueshme, duhet të përmbajë informacion të detajuar rreth profesionistit dhe shërbimit. Në raste të caktuara, veçanërisht për aplikimin e parë,

autoriteti kompetent mund të kërkojë dokumente mbështetëse, por kërkesat kufizohen nga parimi i proporcionalitetit, duke siguruar që ato janë të nevojshme dhe jo burokratike.

Si përjashtim nga ky rregull që garanton ofrimin e lirë të shërbimeve, për profesione me ndikim në shëndetin ose sigurinë publike, mund të kryhet një verifikim paraprak i kualifikimeve. Ky verifikim duhet të përfundojë brenda afateve të caktuara dhe nëse autoriteti nuk përgjigjet në kohë, profesionisti ka të drejtë të fillojë punën. Nëse zbulohen dallime thelbësore, mund të kërkohej një test përshtatshmërie.

Për t'i lehtësuar procesin, profesionisti i përkohshëm përjashtohet nga anëtarësimi i detyrueshëm në organizatat profesionale shqiptare. Megjithatë, mund të kërkohej një regjistrim pro forma për qëllime disiplinore, pa kosto apo burokraci shtesë.

Gjatë ushtrimit të profesionit, ai duhet të respektojë rregullat shqiptare mbi kualifikimin dhe sigurinë dhe të përdorë titullin profesional të shtetit të origjinës, për të shmangur konfuzionin. Përveç kësaj, profesionisti ka detyrimin të informojë marrësin e shërbimit përpara ofrimit të shërbimit mbi kualifikimet e tij, shtetin e origjinës dhe të dhëna të tjera thelbësore, duke siguruar transparencë dhe përgjegjshmëri.

Për të verifikuar vërtetësinë e informacionit, autoritetet shqiptare do të bashkëpunojnë me autoritetet e shtetit të origjinës.

TITULLI III USHTRIMI I PROFESIONIT NË MËNYRË TË PËRHERSHME NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË– Nenet 15-69

Titulli III i projektligjit rregullon mënyrat dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve profesionale të personave që synojnë të vendosen ligjërisht në Republikën e Shqipërisë për ushtrimin e profesionit në mënyrë të përherëshme.

Projektligji përcakton tre sisteme kryesore për njohjen e kualifikimeve profesionale që zbatohen në Bashkimin Evropian:

- i) Sistemi i përgjithshëm i njohjes, nëpërmjet vlerësimit të kualifikimit profesional të fituar në shtetin e origjinës në raport me kërkesat për kualifikimin profesional në Republikën e Shqipërisë, bazuar në nivelet e kualifikimit;
- ii) Sistemi i njohjes automatike mbi bazën e përvojës profesionale, i parashikuar në Kreun III të këtij Titulli;
- iii) Sistemi i njohjes automatike nëpërmjet kushteve minimale të formimit për profesionet sektoriale, i parashikuar në Kreun IV të këtij Titulli;

Gjithashtu, projektligji vendos themelet për zbatimin në Republikën e Shqipërisë të sistemit të njohjes të bazuar në kuadrin e përbashkët të formimit në nivel të Bashkimit Evropian.

Ky titull përbëhet nga 6 (gjashtë) krerë:

- kreu i parë me dispozita të përgjithshme që përcaktojnë taksonominë e mënyrave të njohjes, vendimmarrjen dhe përdorimin e titullit;
- kreu i dytë që lidhet me sistemin e përgjithshëm të njohjes;
- kreu i tretë që lidhet me sistemin e njohjes bazuar në përvojën profesionale për profesionet në fusha të zejtarisë, tregtisë dhe biznesit;
- kreu i katërt që lidhet me sistemin e njohjes bazuar në harmonizimin e kushteve minimale të formimit;
- kreu i pestë që lidhet me sistemin e njohjes bazuar në kuadrin e përbashkët të formimit;
- kreu i gjashtë me dispozita procedurale të përbashkëta për sistemet e njohjes.

Kreu I përcakton taksonominë e sistemeve të njohjes, organet vendimmarrëse dhe përdorimin e titullit profesional në vijim të njohjes.

Kreu II përcakton në mënyrë të hollësishme rregullat dhe procedurat për zbatimin e sistemit të përgjithshëm të njohjes, që vlen për të gjitha rastet kur kualifikimet ose përvoja profesionale nuk i plotësojnë kriteret e njohjes automatike, duke përfshirë edhe shtetasit me kualifikime nga vende të treta, të cilët kanë fituar përvojë profesionale në një shtet anëtar të BE-së.

Njohja e kualifikimeve bëhet në bazë të një kornize të posaçme të kategorizimit profesional të përcaktuar në këtë projektligj. Ky klasifikim ndihmon në krahasimin e standardizuar të kualifikimeve, duke pranuar si të barasvlershme çdo dëshmi kualifikimi që ka të njëjtën kategori në shtetin e origjinës.

Baza për njohjen e kualifikimeve mund të jetë ose një dëshmi e lëshuar nga një profesion i rregulluar, ose, në rastin e një profesioni të parregulluar, një përvojë profesionale prej të paktën një viti.

Megjithatë, autoriteti kompetent ka të drejtë të refuzojë njohjen nëse ekzistojnë dallime thelbësore në nivelin e kualifikimit. Në raste kur përmbajtja e profesionit konsiderohet "thelbësisht e ndryshme", sipas përkufizimit dhe kriterëve të dhëna në ligj, autoriteti mund të kërkojë masa shtesë kompensuese. Këto masa synojnë të mbulojnë diferencat në njohuri ose aftësi dhe i ofrojnë aplikantit zgjedhjen midis dy opsioneve:

- Testi i përshtatshmërisë: Një provim që vlerëson njohuritë, aftësitë dhe kompetencat profesionale të aplikantit, me qëllim vlerësimin e aftësisë së tij për të ushtruar profesionin në Republikën e Shqipërisë.
- Periudha e përshtatjes: Një periudhë praktike, e mbikëqyrur, gjatë së cilës profesionisti ushtron profesionin nën përgjegjësinë e një anëtari të kualifikuar të atij profesioni. Kjo periudhë mund të shoqërohet me formim shtesë dhe i nënshtrohet një vlerësimi final.

Kreu III i këtij titulli përcakton kriteret për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale mbi bazën e përvojës profesionale të fituar në një shtet anëtar.

Ky sistem zbatohet kryesisht për profesione në fushën e zejtarisë, tregtisë dhe industrisë, duke vlerësuar përvojën e strukturuar dhe të dokumentuar si një tregues të mjaftueshëm të kompetencës profesionale.

Kuadri për vënien në jetë të këtij sistemi bazohet në kategorizimin e veprimtarive në tri lista (Lista I, II dhe III) dhe përcaktimin e kriterëve të përgjithshme për njohjen për secilën nga këto listë. Kjo ndihmon në standardizimin e procesit dhe krijon një mekanizëm praktik për njohjen e profesioneve që mbështeten më shumë te përvoja sesa te formimi akademik.

Kërkesat ndryshojnë në varësi të natyrës së veprimtarisë, duke kombinuar vite përvojë si i vetëpunësuar, drejtues sipërmarrjeje apo punëmarrës, me kohëzgjatjen e formimit profesional. Për të gjitha listat, kushti kryesor është që përvoja të jetë e fituar në mënyrë të rregullt dhe brenda një periudhe të caktuar kohore, që në shumicën e rasteve nuk duhet të jetë më e vjetër se dhjetë vjet para aplikimit.

Kreu IV detajon rregullat për njohjen automatike të kualifikimeve profesionale për një grup të caktuar profesionesh sektoriale të rregulluara si mjekët, infermierët, stomatologët, mamitë, veterinerët, farmacistët dhe arkitektët. Ky sistem bazohet në parimin e njohjes reciproke kur kualifikimet e fituara në një shtet anëtar të BE-së plotësojnë kushtet minimale të formimit, të harmonizuara me legjislacionin evropian.

Në legjislacionin shqiptar, kushtet minimale të formimit për këto profesione janë përcaktuar në:

- Ligjin nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë
- Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 41, datë 24.01.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar me VKM nr. 823, datë 28.12.2023
- Projektvendimit “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 824, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë””, i cili është aktualisht në proces përditësimi.

Lista e dëshmimeve të kualifikimit profesional të lëshuara nga një shtet anëtar i BE-së që përmbush kushtet minimale të formimit, ashtu sikurse dëshmitë e lëshuara në Shqipëri, do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas autorizimit të përcaktuar në këtë projektligj, duke u bazuar në përcaktimet e kryera në kuadër të direktivës 2005/36/KE.

Neni 28 parashikon parimin se dëshmitë e kualifikimit nga shtetet anëtare të BE-së, të përfshira në këtë VKM kanë të njëjtin efekt juridik si ato shqiptare.

Nenet vijuese trajtojnë raste specifike për profesione të veçanta. Për shembull, Neni 30 përcakton tre rrugë alternative formimi për njohjen e profesionit të mamisë. Neni 31 parashikon një

përfundim të kufizuar për farmacistët, duke lejuar refuzimin e njohjes automatike vetëm për qëllimin e hapjes së një farmacie të re, përveç rasteve kur profesionisti ka përvojë të mëparshme në Shqipëri. Neni 32 rregullon njohjen e kualifikimeve të arkitektëve, duke vendosur kufizime kohore dhe duke ofruar rrugë alternative për profesionistët që nuk plotësojnë kushtet standarde.

Gjithashtu, ligji siguron që autoritetet shqiptare nuk do të rishikojnë përmbajtjen e kualifikimeve të lëshuara në BE, duke garantuar respektimin e plotë të parimit të njohjes automatike.

Një pjesë e rëndësishme e këtij kreu i dedikohet njohjes së të drejtave të fituara. Këto të drejta garantojnë njohjen e kualifikimeve të fituara para datave të referencës së harmonizimit të plotë me BE-në, me kusht që profesionisti të provojë përvojë profesionale efektive për një periudhë të caktuar. Neni 35 përcakton se kualifikimet e fituara para datave të referencës do të njihen nëse personi ka ushtruar profesionin për të paktën 3 vite brenda 5 viteve para dhënies së certifikatës. Krahas këtij parimi të përgjithshëm, seksioni mbi të drejtat e fituara përfshin raste specifike për kualifikimet e lëshuara për secilin nga këto profesione sektoriale, sipas rrethanave të posaçme.

Kreu V parashikon krijimin e kuadrove të përbashkëta të formimit, të cilat mund të lehtësojnë njohjen automatike të kualifikimeve nëpërmjet një standardizimi të mënyrë së formimit. Ky sistem ende nuk është vendosur në zbatim në Bashkimin Evropian, por projektligji vendos bazat për mënyrën se si do të zbatohen në Republikën e Shqipërisë në të ardhmen.

Kreu VI i ligjit vendos rregullat procedurale për njohjen e kualifikimeve profesionale, duke përshkruar procesin e aplikimit, dokumentacionin e kërkuar dhe mënyrën e verifikimit nga autoritetet kompetente.

Procedura vihet në lëvizje nga kërkesa e paraqitur pranë autoritetit kompetent, i cili ka një afat njëmuajor për të konfirmuar marrjen e saj dhe për të njoftuar për çdo dokument që mund të mungojë. Afati i shqyrtimit të dosjes së plotë është tre muaj, me mundësi shtyrjeje me një muaj në raste të caktuara. Nëse profesionisti nuk merr një vendim brenda këtyre afateve, ai ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e ankimit sipas legjislacionit në fuqi.

Dokumentacioni i nevojshëm përfshin dëshminë e shtetësisë, certifikatat e kualifikimit, dëshmi të përvojës profesionale, dhe, në raste të caktuara, dokumente që vërtetojnë reputacionin e mirë ose gjendjen shëndetësore. Të gjitha dokumentet pranohen në gjuhën zyrtare të shtetit të origjinës, por autoriteti kompetent ka të drejtë të kërkojë përkthimin e tyre në gjuhën shqipe nëse është e nevojshme.

Nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm për vërtetësinë e dokumenteve, autoriteti kompetent shqiptar ka të drejtë të kërkojë konfirmim nga autoritetet përkatëse të shtetit të origjinës. Ky verifikim mund të mbulojë autenticitetin e certifikatave, përputhshmërinë me kushtet minimale të formimit, ose statusin ligjor të profesionistit. Për të lehtësuar këtë proces, shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve kompetente realizohet nëpërmjet Sistemit të Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI).

TITULLI IV – KARTA PROFESIONALE EVROPIANE- Nenet 70 –74

Ky titull përmban parashikime në lidhje me përdorimin e Kartës Profesionale Evropiane në kuadër të njohjes së kualifikimeve profesionale.

Karta Profesionale Evropiane (KPE) është një mjet elektronik që thjeshton dhe përshpejton njohjen e kualifikimeve profesionale. Profesionistët mund ta përdorin këtë kartë si një alternativë ndaj procedurave të tjera të njohjes, qoftë për ofrimin e shërbimeve të përkohshme, qoftë për vendosjen e përhershme në një shtet anëtar.

Në rolin e tyre si shtet i origjinës, autoritetet kompetente shqiptare janë përgjegjëse për të lehtësuar procesin për profesionistët shqiptarë. Kur një profesionist shqiptar aplikon për Kartën Profesionale Evropiane, autoriteti shqiptar siguron që kërkesa të dorëzohet siç duhet dhe krijon dosjen elektronike në Sistemin e Informacionit të Tregut të Brendshëm (IMI). Më pas, ata verifikojnë vërtetësinë dhe vlefshmërinë e dokumenteve të paraqitura dhe, nëse aplikimi është për shërbime të përkohshme pa kontroll paraprak, lëshojnë vetë kartën brenda një afati të caktuar. Në rastet e tjera (për vendosje ose për profesione që kërkojnë kontroll paraprak), autoritetet shqiptare përgatisin dosjen dhe ia transmetojnë atë autoritetit të shtetit pritës, duke ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të ndihmuar profesionistin në këtë proces.

Në anën tjetër, kur veprojnë si shtet pritës, autoritetet shqiptare shqyrtojnë aplikimet e profesionistëve nga BE-ja që synojnë të ushtrojnë profesionin në Shqipëri. Nëse aplikimi është për vendosje ose për një profesion që për ushtrimin e përkohshëm kërkon kontroll paraprak, autoriteti shqiptar ka një afat të caktuar për të shqyrtuar dosjen e dërguar përmes IMI. Gjatë këtij shqyrtimi, ata mund të kërkojnë informacion shtesë nga shteti i origjinës. Një parim thelbësor i këtij kreu është se nëse autoriteti shqiptar nuk merr një vendim brenda afatit të përcaktuar, karta konsiderohet e lëshuar automatikisht. Kjo siguron që mosveprimi i administratës nuk do të pengojë lëvizjen e profesionistëve. Gjithashtu, autoritetet shqiptare janë përgjegjëse për të përditësuar dosjen IMI me çdo masë disiplinore apo sanksion që ndërmerret ndaj mbajtësve të kartës.

TITULLI V – RREGULLA PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT TË RREGULLUAR TË NJOHUR Nenet 75 – 79

Ky titull i projektligjit vendos rregulla të hollësishme që duhet të ndjekin profesionistët pasi kualifikimet e tyre janë njohur në Shqipëri. Qëllimi është të sigurohet që profesionistët të kenë aftësitë e nevojshme për të punuar në tregun shqiptar, duke ruajtur standardet e sigurisë publike dhe duke garantuar njëkohësisht të drejtat e tyre.

Ligji kërkon që profesionistët të kenë njohuritë e domosdoshme të gjuhës shqipe. Megjithatë, autoritetet kompetente mund ta kontrollojnë këtë njohuri vetëm në dy raste: kur profesioni ka ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë publike, ose kur ka dyshime serioze për aftësitë gjuhësore të profesionistit. Ky kontroll mund të kryhet vetëm pasi të jetë përfunduar procedura e njohjes së kualifikimit ose pasi të jetë lëshuar Karta Profesionale Evropiane.

Profesionistët kanë të drejtë të përdorin titujt akademikë të fituar jashtë vendit në gjuhën e tyre origjinale. Megjithatë, nëse një titull mund të shkaktojë konfuzion me një titull profesional shqiptar që kërkon formim shtesë, autoritetet mund të kërkojnë përdorimin e një forme të përshtatur. Për profesionet e mjekut dhe stomatologut, ligji ndalon kërkesën për periudha shtesë formimi apo përvoja për të përfituar miratimin nga fondet e sigurimeve shëndetësore, për sa kohë kualifikimet e tyre janë njohur në përputhje me legjislacionin e shtetit të origjinës.

Projektligji njeh praktikën profesionale të kryer në një shtet anëtar tjetër të BE-së, me kusht që ajo të jetë në përputhje me udhëzimet e publikuara nga autoritetet kompetente shqiptare.

TITULLI VI – PROPORCIONALITETI Nenet 79-88

Ky titull përcakton një kuadër rregullator për të siguruar që çdo dispozitë e re ose e ndryshuar që kufizon aksesin ose ushtrimin e një profesioni të rregulluar, të jetë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Përpara miratimit të një mase të tillë, autoritetet kompetente janë të detyruara të kryejnë një vlerësim paraprak objektiv dhe të argumentuar, duke marrë parasysh natyrën e rrezeve, justifikimin mbi bazën e një objektivit të qartë të interesit publik dhe mundësinë e përdorimit të mjeteve më pak kufizuese. Përveç kësaj, ligji kërkon transparencë dhe përfshirje të palëve të interesuara në procesin e hartimit, si dhe garanton të drejtën për mjet juridik efektiv për çdo person të ndikuar nga këto masa.

TITULLI VII – BASHKËPUNIMI ADMINISTRATIV DHE ASISTENCA NDAJ INDIVIDËVE - Nenet 89-97

Ky titull rregullon bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve shqiptare dhe atyre të BE-së për njohjen e kualifikimeve profesionale. Ai siguron shkëmbim informacioni për masat disiplinore, përdorimin e Sistemit IMI për verifikime dhe krijimin e një mekanizmi alarmi për profesionistët e përjashtuar.

Projektligji parashikon caktimin e një Koordinatori Kombëtar për Profesionet e Rregulluara, i cili ka për detyrë të promovojë zbatimin e unifikuar të ligjit, të mbledhë informacion mbi aksesin në profesionet e rregulluara në vendet anëtare, të shqyrtojë propozime për kuadro dhe testime të përbashkëta trajnimi, si dhe të shkëmbejë praktika të mira mbi zhvillimin profesional të vazhduar dhe masat kompensuese.

Ne veçanti, projektligji parashikon krijimin e një Qendre Asistence, e cila ngrihet me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Kjo qendër ka për qëllim të ofrojë mbështetje për qytetarët dhe të bashkëpunojë me qendrat homologe të vendeve të tjera anëtare të Bashkimit Evropian, për çështje që lidhen me njohjen e kualifikimeve profesionale në bazë të këtij ligji.

Qendra e Asistencës luan një rol informues. Ajo u ofron qytetarëve informacion mbi legjislacionin kombëtar që rregullon profesionet dhe ushtrimin e tyre, mbi legjislacionin përkatës social, si dhe – kur është e nevojshme – mbi rregullat etike që zbatohen në ushtrimin e profesionit. Përmes këtij

shërbimi, synohet që individët të kenë një kuptim të qartë të kuadrit ligjor për të ushtruar profesionin në Shqipëri.

Gjithashtu, kjo qendër ndihmon qytetarët për të ushtruar të drejtat që u garanton ligji, në bashkëpunim me qendrën e asistencës në shtetin e origjinës së profesionistit, me autoritetet kompetente në Shqipëri dhe me pikën unike të kontaktit.

Të gjitha autoritetet kompetente në Shqipëri janë të detyruara të bashkëpunojnë plotësisht me Qendrën e Asistencës, si dhe me autoritetet përkatëse dhe pikat e kontaktit të vendeve të tjera anëtare. Ky bashkëpunim përfshin shkëmbimin e informacionit të nevojshëm për raste individuale, duke respektuar në çdo rast rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale sipas legjislacionit shqiptar dhe atij evropian për privatësinë në komunikimet elektronike.

Me kërkesë të Komisionit Evropian, Qendra e Asistencës duhet të raportojë mbi rezultatet e hetimeve të saj brenda një afati prej dy muajsh nga marrja e kërkesës.

TITULLI VIII – DISPOZITA TË TJERA DHE TË FUNDIT- Nenet 98-102

Përfshin dispozitat përfundimtare, rregullat kalimtare dhe afatet për zbatimin e plotë të këtij ligji.

Ky titull përcakton aktet nënligjore që duhet të miratohen për zbatimin e ligjit dhe rregullon hyrjen në fuqi të tij.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

- Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Arsimit
- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Drejtësisë
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Dhoma Kombëtare e Zejtarisë
- Urdhri i Veterinerëve
- Urdhri i Mjekëve
- Urdhri i Infermierëve
- Urdhri i Farmacistëve
- Urdhri i Stomatologëve

- Dhoma Kombëtare e Avokatisë

VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga Ministria e Arsimit në bashkëpunim me GIZ, në kuadrin e projektit Saneca II dhe ekspertët e kontraktuar për këtë qëllim dhe është ligj me bashkëpropozim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Mjedisit, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Financave.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.

Ky projektligj nuk ka efekte financiare të menjëhershme në buxhetin e shtetit. Aktet e parashikuara për ndryshim janë evidentuar në raportin *screening* dhe kostot buxhetore do të evidentohen me përcaktimin e programit të punës për rishikimin e tyre.

Ndikimi buxhetor i vete ligjit do të evidentohet me hyrjen e në fuqi të dispozitave të tij pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.